



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E MAKROEKONOMISË



EKONOMIA DHE BUXHETI

SHTATOR, 2008

Raporti Mujo

Shtator, 2008

Kontakt:

Telefon: ++355 (4) 225 8437

e-mail: elami@minfin.gov.al

www.minfin.gov.al

PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE	2
ZHVILLIMET EKONOMIKE	3
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi mesatar i këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	7
7. Oferta e Parasë	8
8. Depozitat sipas Burimeve	10
SEKTORI FISKAL.....	11
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
3. Financimi i Sufiçitetit	12
ANEKSI STATISTIKOR.....	13


VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin Shtator, 2008 arriti në 101.3 përqind
- *Norma vjetore e inflacionit* për muaji Shtator ishte 2.7 përqind
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhes vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin Shtator 2008 ishte 85.65 lekë për dollarë dhe 123.05 lekë për euro
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit Shtator shënuan kuotat 6.83 përqind për depozitat 24 mujore, 7.25 për ato 12 mujore, 5.81 për 6 mujorët dhe 5.08 përqind për depozitat 3 mujore
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 10.84 përqind për huatë 12 mujore dhe 12.32 për ato 6 mujore
- *Oferta totale e parasë, e matur nga agregati M3*, arriti në 820 miliardë lekë në muajin Shtator, duke shënuar një rritje prej rreth 14.9 përqind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë
- *Bilanci i pagesave për 6 – muajorin e parë të vitit 2008* rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej 17.0 milion euro.
- *Situata Buxhetore* për periudhën Janar - Shtator, 2008 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej 8.5 miliardë lekë
- *Të ardhurat gjithsej të realizuara* në Janar – Shtator, 2008 arritën në rreth 208.9 miliardë lekë ose rreth 68.8 përqind e planit vjetor 2008
- *Shpenzimet gjithsej* arritën në rreth 217.4 miliardë lekë ose rreth 60.4 përqind e totalit të shpenzimeve të planifikuara për vitin 2008

ZHVILLIMET EKONOMIKE

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Shtator 2008 pësoi një rritje prej 1.1 përqind krahasuar me muajin Gusht dhe Korrik, kur ky indeks shënonte përkatësisht 0.6 përqind dhe -0.6 përqind. Ndryshimet respektive në të njëjtët muaj të një viti më parë ishin 0.9 përqind, 1.9 përqind dhe -0.3 përqind. Rritja me e madhe mujore, gjatë muajit



Ndryshimet mujore të IÇK-së

Burimi: INSTAT

Shtator u konstatua në grupin “Argëtim dhe kulturë” 10.2 përqind, rritje e cila erdhi si rrjedhojë e rritjes së çmimeve të nëngrupit “Gazeta, libra dhe mjete shkollore” me 32.2 përqind. Pësha specifike relativisht e ulët që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit, bën që ndryshimet e çmimeve për këtë grup të kenë efekte të ndieshme mbi normën e inflacionit.

Gjatë këtij muaji rënien më të madhe prej 9.1 % e pësoi indeksi i çmimit të grupit “Komunikimi”.

Tab - 1 Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
2007	2.9	2.9	2.7	1.9	1.4	2.0
2008	3.0	3.6	4.6	4.4	4.2	4.0
VITI	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
2007	2.1	4.2	4.4	4.2	3.5	3.1
2008	3.7	2.5	2.7			

Burimi: INSTAT

Norma vjetore e inflacionit në muajin Shtator arriti në 2.7 përqind duke qëndruar brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2007 dhe 2008 paraqiten në tabelën 1.

2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt Euros në muajin Shtator 2008, arriti në 123.05 Lekë/Euro, duke shënuar një rënie prej 1.33 përqind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Shtator një euro u këmbye me 123.89 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Shtator 2008, arriti në 85.65 lekë/dollarë duke shënuar një rritje prej 5.58 përqind kundrejt muajit Gusht. Në fund të muajit Shtator, dollari amerikan arriti nivelin 86.38 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin Shtator të vitit të kaluar rezulton se monedha shqiptare është vlerësuar ndaj dollarit amerikan në masën 3.9 përqind dhe kundrejt monedhës europiane, Euro, me 0.6 përqind.



Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit Shtator '08


sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rënie mesatare duke arritur në rreth 1.437 euro/dollarë.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji përmendim: ruajtjen e ritmeve pozitive të ekonomisë në vend, efikasitetin politikës fiskale, efikasitetin në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.


Mbicmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane Euro dhe monedhës amerikane, në rradhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar

3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Shtator 2008, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 7.25 përqind, duke pësuar një rënie prej 0.46 përqind në krahasim me muajin gusht ku normat e interesit shënonin vlerën 7.71 përqind. Rënie për këtë muaj kanë



Normat e interesit për depozitat




Normat e interesit për huatë

pësuar depozitat me afat 6-mujor të krahasuara me muajin paraardhës me 0.28 përqind, normat e interesit për depozitat me afat 3 - mujor me 1.19 përqind, si dhe normat e depozitave me afat 1 - mujor me 0.20 përqind krahasuar gjithmonë me muajin paraardhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rritje kanë pësuar të gjitha normat e interesit të depozitave me afat 12, 6, 3 dhe 1 mujore. Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit Shtator pësoi një rënie 1.48 pikë përqind, duke arritur në 10.84 përqind nga 12.32 përqind që ishte në muajin gusht. Për këtë muaj norma e interesit të huave 6-mujore pësuan një rritje prej 0.28 pikë përqind krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin Shtator arriti në 12.32 përqind. Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit Shtator 2008, për bonot me maturim 12 mujor, 6 mujor dhe 3


mujor, ishin përkatësisht 8.02 përqind, 7.33 përqind dhe 6.24 përqind. Gjatë këtij muaji vihet re një rënie në Yield-et e bonove të thesarit për afatet e maturimit 12, 6 dhe 3 mujor.

4. Bilanci i Pagesave



Bilanci i Pagesave
Burimi: Banka e Shqipërisë

Bilanci i pagesave për periudhën Janar – Qershor 2008 regjistroi një defiqit të përgjithshëm prej 17.0 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në grafikun 5.




Llogaria Korente
Burimi: Banka e Shqipërisë

Kompozicioni i defiqitit të llogarisë korente prej 590.7 milion euro i shprehur sipas elementëve kryesorë përbërës (ne terma neto) për periudhën janar'08 - qershor'08 rezultoi: (i) bilanci tregtar -1,106.9 mln euro, (ii) shërbime neto -82.6 mln euro, (iii) të ardhura neto 129.3 mln euro, (iv) transferta neto 469.5 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet ne grafikun 6.

5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Shtator 2008, sistemi bankar ka shënuar rënie të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 4,375.1 milionë lekë krahasuar me fundvitin 2007. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e



rritjes të mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë me rreth 17,550.6 milionë lekë dhe të rënies së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë, me rreth 13,175.5 milionë lekë. Në muajin Shtator sistemi bankar rezulton me një rritje prej 9,823.8 milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin gusht, rritje e cila erdhi si rezultat i rritjes së nivelit të mjeteve valutore neto

të bankave të nivelit të dytë me rreth 1,607.6 milionë lekë si dhe të rritjes së mjeteve valutore neto në Bankën e Shqipërisë, me rreth 8,216.2 milionë lekë.

6. Kredia për Ekonominë


Teprica e kredisë për ekonominë për muajin Shtator 2008 arriti në 377 miliardë lekë. Rritja e tepricës së kredisë, krahasuar me fundvitin 2007 shënoi vlerën 83.7 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 28.5 përqind. Kredia e akorduar nga sistemi bankar edhe gjatë këtij muaji shënoi rritje duke ndjekur kështu të njëjtin trend rritës si në vitin 2007.

Nga struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizoterohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 72.4 përqind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 273.2 miliardë lekë.

Këtë muaj pesha specifike e kredive për individët, arriti në nivelin 35.9 përqind.


7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin Shtator ka shënuar një rritje krahasuar me muajin paraardhës Gusht. Kjo ofertë arriti në rreth 820 miliardë lekë në fund të muajit Shtator duke shënuar një rritje prej 62.6 miliardë lekë kundrejt nivelit të regjistruar në muajin Dhjetor 2007. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 14.9 përqind, duke ruajtur




kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i vitit të kaluar. Kjo rritje vjetore, erdhi si pasojë e rritjes së depozitave pa afat në lekë me rreth 7.9 përqind, rritjes së depozitave në valutë me rreth 25.4 përqind, depozitave me afat në lekë me rreth 13.1 përqind dhe rënies të parasë jashtë sistemit me rreth 3.5 përqind.

Ndikimin kryesor në rritjen e ofertës monetare gjatë muajit Shtator e kanë patur rritja e depozitave me afat në lekë, të cilat vetëm gjatë këtij muaji u rritën me rreth 0.5 miliardë lekë, rritjes së depozitave në valutë me 9.5 miliardë lekë, si dhe rritjes së depozitave pa afat në lekë me rreth 0.7 miliardë lekë. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare, në fund të muajit Shtator arriti në 18.6 përqind duke shënuar një rënie në krahasim me muajin gusht. Raporti i parasë jashtë bankave me depozitat në muajin Shtator arriti në rreth 22.8 përqind, duke shënuar një rënie prej 0.3 përqind e krahasuar me muajin gusht.



Graf - 10




Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rritje prej 1.3 miliardë lekë në krahasim me muajin gusht.

Graf - 11




Raporti i Depozitave ndaj M3

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në valutë gjatë muajit Shtator, janë mbështetur kryesisht nga depozitat e sektorit privat, të cilat kanë përbërë rreth 76.8 përqind të depozitave totale në valutë.

8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit Shtator 2008 sektori i individëve, zuri nivelin më të lartë të depozitave pa afat në lekë, me rreth 49.6 përqind, ndjekur nga sektori privat, me rreth 39.1 përqind dhe nga ndërmarrjet publike jofinanciare, me 8.9 përqind. Individët dhe sektori privat ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhe të huaj, përkatësisht me rreth 76.8 përqind dhe rreth 18.8 përqind. Familjarët ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave me afat në lekë (96.2 përqind e totalit)



Përberja e depozitave

Burimi: Banka e Shqipërisë

krahasuar me një muaj më parë gusht, niveli i përgjithshëm i depozitave u rrit me 10.8 miliardë lekë, si rezultat i rritjes së depozitave në valutë dhe atyre në lekë.


Në përgjithësi, familjarët përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 547 miliardë) të depozitave totale, prej rreth 668 miliardë lekë në muajin Shtator 2008. Ata ndiqen nga sektori privat (95.5 miliardë), ndërmarrjet publike jo-financiare (18.5 miliardë) dhe autoritetet lokale (4.2 miliardë). Institucionet financiare kontribuan me rreth 3.0 miliardë në totalin e depozitave.

Gjatë muajit Shtator 2008,

SEKTORI FISKAL

1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhen Janar – Shtator 2008, janë mbledhur rreth 208.9 miliardë lekë të ardhura, përkundrajt shpenzimeve të përgjithshme prej 217.4 miliardë lekë, që përfshijnë 169.5 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 45.5 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 42.7 % financim i brendshëm, dhe 57.3 % financim i huaj.



Treguesit Fiskal, Shtator 2008

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 68.8 % të të ardhurave buxhetore për vitin 2008, ndërsa shpenzimet përbëjnë 60.4 % të buxhetit të planifikuar. Shpenzimet korrente janë rreth 65.7 % e planifikimit vjetor, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 48.2 % e këtij planifikimi.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave është rreth 149.9 miliardë lekë (ose rreth 71.5 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor 8.4 miliarde lekë (53.9 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 34.3 miliarde lekë (67.1 % e të ardhurave vjetore të planifikuara), dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin e 15.6 miliardë lekë (68.5 % e të ardhurave vjetore të planifikuara). Nga totali i shpenzimeve korrente prej 169.5 miliardë lekë, 46.3 miliardë lekë (27.3 % e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, 23 miliardë lekë (13.6 %) për interesat, 16.6 miliardë lekë (9.8 %) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 1.5 miliardë lekë (0.9 %) për subvencione, 55.4 miliardë lekë (32.7%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 17.2 miliardë lekë (10.1 %) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 9.5 miliardë lekë (5.6 %) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 68.2 % (shpenzime personeli), 70.6 % (shpenzime për interesat), 58 % (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 76.6 % (subvencione), 70.5 % (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 54.3 % dhe 61.2 % (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrajt buxhetit të planifikuar vjetor. Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë llogariten në rreth 39.8% të buxhetit të parashikuar vjetor, ndërsa financimi i huaj është vetëm 57.2 %.

2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën Janar - Shtator 2008 ishin rreth 208.9 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore në rreth 192.6 miliardë, grantet 721 milionë dhe të ardhurat jo-tatimore në rreth 15.6 miliardë

Tab - 2 Të ardhurat e realizuara në Janar - Shtator 2008

Burimi	Miliardë Lekë
TVSH	78.0
Tatimi mbi fitimin	13.5
Taksa doganore	6.3
Taksat nacionale	11.0
Akcizat	24.9
Transferim fitimi nga Banka e Shqipërisë	1.5

3. Financimi i Deficitit

Deficiti prej 8.5 miliardë lekë, për periudhën Janar-Shtator, u mbështet në vlerën 10.3 miliardë lekë nga burime të brendshme dhe 18.7 miliardë lekë me financim të huaj. Emetimi i bonove të thesarit ishte mjete kryesor i financimit të brendshëm, ndërsa për financimin e huaj ishin huatë afatgjata.

Për muajin Shtator disa nga treguesit kryesorë fiskal ishin:

- Realizimi i Të Ardhurave në masën 23.9 miliardë lekë.
- Realizimi i Shpenzimeve në masën 23.5 miliardë lekë

Në realizimin e të ardhurave për këtë periudhë kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga Tatimet dhe Doganat të cilat kapin shifrën e 18.0 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën më të lartë e zënë shpenzimet korrente me 79.8 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me 3.7 miliardë lekë.

Aneksi Statistikor

Tab - 1 Ndryshimi i Indeksit të Çmimemeve të Konsumit
Change of Consumer Prices Index

Muaji	Mujor (Monthly)				Mesatar Mujor (Monthly Average)				Vjetor (Annual)				Month
	2005	2006	2007	2008	2005	2006	2007	2008	2005	2006	2007	2008	
Janar	0.8	0.2	0.5	0.5	0.80	0.20	0.50	0.50	3.3	1.4	2.9	3.0	January
Shkurt	0.4	0.4	0.5	1.0	0.60	0.30	0.50	0.75	1.8	1.3	2.9	3.6	February
Mars	0.0	0.1	-0.1	0.9	0.40	0.23	0.30	0.80	1.6	1.5	2.7	4.6	March
Prill	-0.3	0.6	-0.2	-0.4	0.23	0.33	0.18	0.50	1.3	2.4	1.9	4.4	April
Maj	-1.1	-0.4	-0.8	-1.0	-0.04	0.18	-0.02	0.20	2.0	3.1	1.4	4.2	May
Qershor	-0.5	-1.1	-0.6	-0.8	-0.12	-0.03	-0.12	0.03	2.9	2.4	2.0	4.0	June
Korik	-1.2	-0.4	-0.3	-0.6	-0.27	-0.09	-0.14	-0.06	1.8	3.2	2.1	3.7	July
Gusht	0.2	-0.2	1.9	0.6	-0.21	-0.10	0.11	0.03	2.3	2.8	4.2	2.5	August
Shtator	0.9	0.6	0.9	1.1	-0.09	-0.02	0.20	0.14	3.1	2.6	4.4	2.7	September
Tetor	0.4	0.1	-0.1		-0.04	-0.01	0.17		3.3	2.2	4.2		October
Nendor	0.2	0.9	0.2		-0.02	0.07	0.17		3.0	2.9	3.5		November
Dhjetor	2.2	1.8	1.3		0.10	0.22	0.27		2.0	2.5	3.1		December

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source : INSTAT, Bank of Albania

Monedha	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008								Currency	
										Jan	Feb	Mar	Apr	May	Jun	Jul		Aug
<i>Leke per njesi te monedhes se huaj (Leke per unit of foreign currency)</i>																		
<i>Mesatarja e periudhes</i>																		<i>Average of period</i>
USD	143.71	143.48	140.15	121.86	102.78	99.86	98.10	90.43	83.39	83.90	80.32	77.79	78.45	78.46	77.24	81.12	85.65	USD
EURO	132.58	128.47	132.36	137.51	127.67	124.19	123.08	123.63	122.61	123.69	124.59	122.68	122.08	122.03	121.87	121.44	123.05	EURO
<i>Fundi i periudhes</i>																		<i>In the end of period</i>
USD	146.08	137.04	135.97	106.58	92.64	103.58	93.67	82.89	82.61	82.58	78.29	78.94	78.65	77.17	78.01	82.66	86.38	USD
EURO	-	-	137.90	134.32	126.35	122.58	123.70	121.78	122.61	125.34	123.70	122.75	122.01	122.05	121.80	121.70	123.89	EURO

Burimi : Banka e Shqiperise

Source : Bank of Albania

Tab - 3 Normat e interesit me baze vjetore
Annual Interest Rates

2008											
Ne perqindje Fundi i periudhes	Dhjetor 07 Dec	Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Korrik Jul	Gusht Aug	Shtator Sep	In percent End of period
Norma e remunerimit											Remuneration rate
ne leke	-	4.37	4.37	4.37	4.37	4.37	4.37	4.37	In Lek
ne usd	-	2.30	2.19	1.87	2.02	1.87	1.72	1.73	In USD
ne euro	-	2.92	2.93	3.07	3.07	3.07	3.14	3.14	in EURO
Norma e depozitave											Deposits rates
12-M	6.33	6.49	6.10	6.11	6.41	6.72	6.65	7.72	7.71	7.25	12-M
6-M	5.50	5.56	5.44	5.42	5.64	5.61	5.76	5.99	6.09	5.81	6-M
3-M	4.85	5.08	4.80	4.84	5.08	4.96	5.00	5.21	6.27	5.08	3-M
1-M	3.21	3.59	3.48	3.58	3.62	4.36	4.61	4.63	5.09	4.89	1-M
Norma e huase											Lending rates
12-M	13.55	13.36	11.78	11.48	12.92	11.50	11.40	11.45	12.32	10.84	12-M
6-M	13.85	15.53	14.29	13.50	12.40	12.40	13.66	12.49	12.04	12.32	6-M
Norma e letrave me vlere											Securities rates
Bobo thesari 1/											Treasury bills 1/
3-M	6.48	6.20	6.26	6.25	6.29	6.28	6.27	6.28	6.26	6.24	3-M
6-M	7.51	7.30	7.29	7.36	7.47	7.48	7.46	7.46	7.39	7.33	6-M
12-M	8.41	8.14	8.00	8.02	8.12	8.16	8.19	8.21	8.15	8.02	12-M

Burimi : Banka e Shqiperise

Source : Bank of Albania

Tab - 4 TREGUESIT FISKALE SIPAS BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2008

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2008

Te dhena progresive (Progressive Data)		ne milion leke (in million leks)								
Nr.	E M E R T I M I	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Korrik Jul	Gusht Aug	Shtator Sep	ITEM	No.
	TOTALI TE ARDHURAVE	63,566	87,807	111,542	134,889	161,135	184,974	208,922	TOTAL REVENUE	
I.	Ndihma	41	250	466	521	623	705	721	Grants	I.
II.	Te ardhura tatimore	60,462	82,618	103,004	123,998	147,274	170,175	192,617	Tax Revenue	II.
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	46,867	62,853	79,253	96,093	113,410	131,902	149,942	From tax offices and customs	II.1
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	24,021	32,423	40,714	49,745	59,085	68,206	77,998	V. A. T	1
2	Tatimi mbi Fitimin	6,052	7,305	8,646	9,839	10,876	12,282	13,474	Profit Tax	2
3	Akizatat	6,518	9,070	12,044	14,940	17,737	21,804	24,880	Excise Tax	3
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	4,817	6,563	8,332	9,996	12,349	14,258	16,259	Personal Income Tax	4
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	3,400	4,656	5,966	7,309	8,410	9,696	10,990	National Taxes and others	5
6	Taksa Doganore	2,059	2,835	3,550	4,264	4,953	5,657	6,340	Custom Duties	6
II.2	Te ardhura nga Pushteti Lokal	2,422	4,345	4,858	5,462	7,106	7,729	8,399	Revenues from Local Gov.	II.2
1	Taksa Lokale	1,677	3,160	3,570	4,050	5,290	5,858	6,414	Local Taxes	1
2	Tatimi mbi Biznesin e vogel	745	1,185	1,289	1,412	1,816	1,871	1,985	Small Business Tax	2
II.3	Te ardh. Buxh. Pavarur	11,173	15,420	18,893	22,443	26,758	30,545	34,277	Social Ins	II.3
1	Sigurimi Shoqeror	9,973	13,776	16,875	20,048	23,918	27,345	30,676	Social Insurance	1
2	Sigurimi Shendetosor	1,201	1,644	2,018	2,395	2,841	3,200	3,600	Health insurance	2
III.	Te ardhura Jotatimore	3,063	4,939	8,072	10,371	13,238	14,094	15,584	Nontax Revenue	III.
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shoqiperise	0	0	1,500	1,500	1,500	1,500	1,500	Profit transfer from BOA	1
2	Te ardhura nga Inst.Buxhetore	2,878	4,355	5,419	6,427	6,935	8,530	8,570	Income of budgetary institutions	2
4	Te tjera	185	584	1,153	2,444	4,803	4,064	5,513	Other/not allocated	4
	TOTALI I SHPENZIMEVE	53,214	78,466	106,621	137,320	166,722	193,952	217,317	TOTAL EXPENDITURE	
I.	Shpenzime Korrente	48,032	67,306	87,291	107,787	129,752	149,853	169,539	Current Expenditures	I.
I.1	Personeli	14,172	19,631	24,700	29,991	35,646	40,990	46,344	Personnel expenditures	I.1
1	Paga	11,730	16,307	20,546	24,946	29,743	34,227	38,662	Wages	1
2	Kontributi per Sigurime Shoqerore	2,442	3,324	4,154	5,045	5,904	6,763	7,682	Social insurance contributions	2
3	Politikat e reja pagash								Of which: Contingency	3
I.2	Interesat	6,926	9,190	12,359	15,021	18,758	21,065	22,994	Interest	I.2
1	Te Brendshme	6,578	8,714	11,304	13,636	17,308	19,383	21,177	Domestic	1
2	Te Huaja	348	476	1,055	1,385	1,451	1,682	1,818	Foreign	2
I.3	Shpenzime Operative Mirembajtje	3,703	5,744	7,856	10,451	12,804	14,611	16,624	Operational & Maintenance	I.3
I.4	Subvencionet	207	287	700	884	961	1,388	1,506	Subsidies	I.4
I.5	Shpenzime per Sig.Sociale dhe te tjera	16,640	22,642	28,623	35,022	41,796	48,759	55,423	Social insurance outlays	I.5
1	Sigurime Shoqerore	14,400	19,554	24,641	30,154	36,002	42,098	47,917	Social insurance	1
2	Sigurime Shendetosore	2,240	3,088	3,983	4,868	5,794	6,661	7,506	Health insurance	2
I.7	Shpenzime per Buxhetin Lokal	3,776	6,105	8,222	10,469	12,723	14,815	17,196	Local Budget	I.7
I.8	Shpenzime te tjera	2,608	3,707	4,831	5,950	7,062	8,225	9,452	Other expenditures	I.8
1	Pagesa e Papunesise	193	260	344	425	499	567	633	Unemployment insurance benefits	1
2	Ndihma Ekonomike	2415	3,448	4,486	5,524	6,563	7,658	8,819	Social assistance	2
3	Kompensim per ish te perndjekurit politike								Compensation for ex political prisoners	3
I.9	Kompensim ne vleren e pronareve								Property Compensation	I.9
II.	Fondi Rezerve								Reserve fund/contingency	II.
III.	Shpenzime Kapitale	5,182	10,262	16,984	28,016	34,744	41,814	45,450	Capital expenditures	III.
1	Financimi Brendshem	4,345	5,882	8,262	11,307	13,648	16,637	19,376	Domestically financed	1
2	Financimi Huaj	837	4,380	8,722	16,709	21,096	25,177	26,074	Foreign financed	2
IV	Rindertimi i Gerdecit	898	1,346	1,517	2,227	2,227	2,284	2,328		
	DEFICITI	10,352	9,341	5,921	-2,431	-5,588	-8,978	-8,395	Overall Deficit	
	FINANCIMI DEFICITIT	-10,352	-9,341	-5,921	2,431	5,588	8,978	8,395	Deficit Financing	
	Brendshem	-10,561	-9,877	-7,225	-8,464	-5,931	-9,419	-10,313	Domestic	
	Te ardhura nga privatizimi	121	198	298	400	686	740	832	Privatization receipts	
	Hua-marje e brendeshme	5,450	5,100	6,563	10,517	5,856	12,132	10,569	Domestic Borrowing	
	Te tjera	-16,132	-15,175	-14,085	-19,381	-12,473	-22,290	-21,713	Other	
	I Huaj	209	536	1,303	10,896	11,519	18,396	18,708	Foreign	
	Hua afatgjate(e marre)	910	1,070	1,834	12,357	13,157	19,693	20,830	Long-term Loan(Drawings)	
	Ndryshimi i gjendjes se arkës*	-178	35	38	145	139	609	506	Chang. of stat. Account*	
	Ripagesat	-523	-569	-569	-1,606	-1,778	-1,905	-2,628	Repayments	
	KAPITULI KRYESORE								Main indicators	
	Financimi i Brendshem i Deficitit								Domestically financed deficit	
	Deficiti Pergjithshem								Overall Balance	
	Te ardh.-Shpen.nga Sig. Shoq.dhe Shend.								Soc.& health insur.contr.-outlays	

* "Ndryshimi i gjendjes se arkës" perfaqeson ndryshimin ne Depozites se Financimeve te Huaja

Chang. of stat. Account stands for the change in Foreign Financing Deposit

Tab - 5 SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT INSTITUCIONAL PER VITIN 2008
Expenditures by central institutions during the year 2008

ne milion leke (in million leks)

Ministria ose Institucioni	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Ministry or Institution
	Mar	Apr	May	Jun	Jul	Aug	Sep	
Totali	53,098	78,466	105,621	137,320	166,722	193,878	217,317	Total
Presidenca	33	44	59	69	83	93	104	President
Kuvendi	198	266	333	406	500	548	615	Parliament
Keshilli i Ministrave	66	100	127	130	157	176	192	Council of Ministers
Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	172	375	512	586	651	720	809	Ministry of Economy, Trade & Energy
Ministria e Bujqesise dhe Ushqimit dhe mbrojtjes se Konsumatorit	574	891	1,226	1,673	2,256	2,580	3,143	Ministry of Agriculture, Food & Consumers Safety
Ministria e Puneve Publik, Transportit dhe Telekomunikacionit	4,219	8,566	14,771	24,299	29,913	36,680	39,217	Ministry of Public Work, Transport & Telecommunication
Ministria e Financave	1,034	1,509	1,911	2,401	2,819	3,216	3,652	Ministry of Finance
Ministria e Arsimit dhe Shkences	6,237	8,825	11,634	14,551	17,455	19,941	22,614	Ministry of Education & Science
Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	274	435	587	775	898	1,032	1,174	Ministry of Tourism, Culture, Youth & Sport
Ministria e Shendetesise *	4,713	6,778	8,722	10,834	12,839	14,928	16,928	Ministry of Health
Ministria e Drejtesise	670	971	1,278	1,661	2,009	2,342	2,725	Ministry of Justice
Ministria e Puneve te Jashtme	528	713	895	1,132	1,332	1,443	1,623	Ministry of Foreign Affairs
Ministria e Brendshme	2,600	3,572	4,633	5,975	7,085	8,296	9,313	Ministry of Interior
Ministria e Mbrojtjes	3,167	4,364	5,363	6,974	8,286	9,302	10,638	Ministry of Defense
Sherbimi Informativ i Shtetit	232	315	393	475	564	643	743	State Information Service
Drejtoria e Radio-Televizionit	101	132	191	228	262	302	335	Department of Radio and Television
Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	26	44	52	64	88	98	113	General Directorate of Archive
Akademia e Shkencave	12	20	25	33	40	68	47	Science Academy
Sherbimi i Kontrollit te Shtetit	53	71	90	111	131	156	177	State Audit Commission
Ministria e Punes, Ceshjve Sociale dhe Shanseve te barabarta**	16,346	22,385	28,420	34,830	41,721	48,790	55,727	Ministry of Labor and Social Affairs & Equal Possibilities
Ministria e Mjedisit, Pjjeve dhe Administrimit te Ujrave	209	344	435	569	676	768	883	Ministry of Environment, Forestry & Water Administration
Prokuroria e Pergjithshme	200	278	354	444	525	601	680	State Prosecutor
Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	250	348	450	543	678	761	852	Office for the Administration of the Judiciary Budget
Gjykata Kushtetuese	18	26	34	44	60	62	67	Constitutional Court
Agjensia Telegrafike Shqiptare	36	37	47	54	63	70	78	Albanian Press Agency
Shpenzime per sherbimin e bonxhit	6,926	9,190	12,359	15,021	18,758	21,065	22,994	Dept Service
Instituti i Statistikes	39	51	69	81	94	107	123	Statistics Institute
Autoriteti i Mbrojtjes Financiare	8	10	13	13	13	13	13	Securities Commission
Shkolla e Magjistratures	11	15	18	24	32	35	39	School of the Magistrature
Fondi i Zhvillimit Shqiptar	119	215	265	378	522	586	615	Rural Development Program
Qendra Kombetare Kinematografike	8	40	70	90	96	103	107	National Movies Center
Instituti i integrimit te perndjekurve	7	11	13	16	19	23	25	Institute of integration of the ex political prisoners
Inspektoriat i keshillit te larte te drejtesise	16	22	27	39	45	47	52	Inspection of the high Council of Justice
Avokati i popullit	20	31	37	45	59	61	66	Ombudsman
Komisioni i Sherbimit Civil	8	11	14	17	22	25	27	Commission of civil service
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	23	31	37	44	53	59	67	Central Committee for Elections
Entet Lokale "Granti"	3,776	6,105	8,222	10,469	12,723	14,812	17,196	Local Entities "Grant"
Inspektoriat i Larte Kontr. Deklar te Pronave	12	21	32	39	46	51	57	High Inspectoriate for Declaration of Properties & Assets
Autoriteti i Konkurences	10	18	21	25	29	34	41	Competition Authority
Ministria e Integrimit	24	33	44	53	67	74	81	Ministry of Integration
Agjentet tatimor jo-buxhetore	19	71	110	155	201	201	218	Tax agents not-budgetary
Keshilli Kombetar i Kontabilitetit	2	2	3.39	3.87	5	6	7	
Avokati i Prokurimeve	5	9	10.98	16.49	18	19	21	
Te tjera	96	1,171	1,716	1,928	2,831	2,939	3,114	

Te dhena operative

Tab - 6 SHPENZIMET SIPAS KLASIFIKIMIT FUNKSIONAL PER VITIN 2008
EXPENDITURES BY FUNCTIONS YEAR 2008

Te dhena progresive (Progressive Data)

ne milion leke (in million leks)

Kodi	Funkcionet	Mars Mar	Prill Apr	Maj May	Qershor Jun	Korrik Jul	Gusht Aug	Shtator Sep	Functions	Code
	TOTAL	53,098	78,466	105,621	137,320	166,722	193,878	217,317	TOTAL	
01	Sherbimet e Pergjithshme Publike *	12,438	17,329	22,917	28,161	34,647	39,209	43,735	General Public Services	01
02	Mbrojtja	1,840	2,511	3,026	4,181	4,968	5,557	6,320	Defense	02
03	Rendi dhe Siguria Publike	2,760	3,860	5,071	6,551	7,859	9,160	10,346	Public Order and Safety	03
04	Ceshtjet Ekonomike	5,253	10,562	16,932	27,270	33,815	40,616	44,260	Economic affairs	04
05	Mbrojtja e Mjedisit	18	29	35	46	53	73	81	Environmental protection	05
